

URDHËR
Nr. 36, datë 8.3.2016

**PËR SHPALLJEN E DISA NDRYSHIMEVE NË STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË
KONTABILITETIT DHE TË RAPORTIMIT FINANCIAR, TË PËRKTHYERA NË
GJUHËN SHQIPE**

Në mbështetje të nenit 4, të pikës 3, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, të vendimit nr. 2, datë 24.2.2016, të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, “Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve të ndodhura për SNRF-të dhe SNK-të gjatë vitit 2015”, të cilat hyjnë në zbatim pas datës 1 janar 2016.

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) si më poshtë:

Titulli	Data efektive
Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28	Pas 1 janarit 2016

2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Arben Ahmetaj

Data efektive e ndryshimeve të SNRF 10 dhe SNK 28

Ndryshime në SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara

Në shtojcën C është ndryshuar paragrafi C1C. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Data e hyrjes në fuqi

...

C1C *Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse* (Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28), i publikuar në Shtator 2014, ndryshoi paragrafët 25–26 dhe shtoi paragrafin B99A. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për transaksione që ndodhin në periudhat vjetore që fillojnë ~~me 1 Janar 2016~~ e në vijim, data do të përcaktohet nga BSNK. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Ndryshimet në SNK 28 Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta

Është ndryshuar paragrafi 45C. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

45C *Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse* (Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28), i publikuar në Shtator 2014, ndryshoi paragrafët 28 dhe 30 dhe shtoi paragrafët 31A–31B. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për transaksione që ndodhin në periudhat vjetore që fillojnë ~~me 1 Janar 2016~~ e në vijim, data do të përcaktohet nga BSNK. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

